



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 168, Datë 05.08.2021

MBI

MIRATIMIN E KALENDARIT TË MONITORIMEVE PËR PERIUdhËN  
01.09.2021- 30.09.2022

Në mbështetje të nenit 16, nenit 18 gërma “e”, nenit 19 gërma “g”, nenit 20 dhe nenit 22 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 12.03.2021 “Mbi miratimin e objektivave strategjike të ERE për periudhën 2021 – 2023”, vendimit të bordit të ERE-s nr. 203, datë 12.02.2019 “Mbi miratimin e rregullave për monitorimin e tregut të energjisë elektrike”, nenet 13, 22, 24, 25, 26 dhe 27 të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 199 datë 27.11.2020; nenit 16 të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 05.08.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 110/4 prot., datë 02.08.2021 mbi “Miratimin e Kalendarit të Monitorimeve për periudhën 01.09.2021-30.09.2021” të përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

**Konstatohet se:**

- Në nenin 20 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar përcaktohen të drejtat e ERE-s:
  - Monitoron dhe kontrollon funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe detyron të licencuarit të ndërmarrin masa të nevojshme për nxitjen e konkurrencës efektive dhe sigurinë e funksionimit të tregut.
  - Kontrollon nëse shërbimi është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kushtet e licencës apo rregulloret e miratuara nga ERE;
  - Shqyrton dhe miraton në përputhje me parimin e planifikimit me koston më të ulët, planet e investimeve të operatorëve të transmetimit dhe shpërndarjes dhe monitoron zbatimin e tyre;
  - Monitoron zbatimin e kontratave të lidhura midis të licencuarve duke ushtruar të drejtën eksese mbi dokumentacionin dhe informacionin e të licencuarit dhe duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të marrë.
- Neni 22 i ligjit nr. 43/2015, i jep të drejtën ERE-s për të monitoruar, kontrolluar dhe inspektuar nëse shërbimi është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kushtet e

licencës apo rregulloret e miratuara nga ERE, në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore, kushteve të kontratës si dhe zbatimin e vendimeve dhe urdhrave të ERE-s.

- Në kalendarin e masave të Entit të Rregullator të Energjisë për fillimin dhe ndjekjen e zbatimit të Objektivave Strategjike të ERE-s, për periudhën 2021-2023 janë planifikuar të zhvillohen monitorimet si më poshtë vijojnë:
  - Monitorime për FSHU sh.a. dhe furnizuesit në treg të lirë;
  - Monitorim i zhvillimit të vazhdueshëm në nivel teknik dhe rregullator të tregut rajonal;
  - Monitorimin e sjelljes së operatorëve të tregut, veçanërisht në zbatimin e Rregullores Evropiane REMIT;
  - Monitorimin e zhvillimit të vazhdueshëm në nivel teknik dhe rregullator të tregut rajonal.
- Planifikimi i këtyre monitorimeve nuk përjashton të drejtën e cdo drejtorie për të ushtruar monitorime të tjera me objekt të ndryshëm nga objektet e subjekteve të licencuara në këtë kalendar me qëllim të ushtrimit të aktivitetit të saj.
- Referuar kushteve të licensave respektive përfaqësues të autorizuar të ERE-s kanë të drejtë të monitorojnë objektet e të Liçensuarit, pajisjet dhe dokumentat e tij për të verifikuar përputhjen e kryerjes së Aktivitetit të Liçensuar me kushtet e liçenses si dhe aktet ligjore në fuqi. I liçensuari do të marrë cdo masë të nevojshme për të siguruar monitorimin nga ana e ERE pas marrjes së njoftimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të miratojë Kalendarin e Monitorimeve të planifikuar për periudhën 01.09.2021-30.09.2022 sipas tabelës bashkëlidhur vendimit.
2. Ngarkohet çdo strukturë e ERE-s për zbatimin e këtij vendimi dhe akteve të tjera nënligjore për qëllime të ushtrimit të monitorimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KALENDARI I MONITORIMEVE TË PLANIFIKUARA TË ENTIT TË  
RREGULLATOR TË ENERGJISË PËR PERIUDHËN 01.09.2021- 30.09.2022**

	<b>Objekti i monitorimit</b>	<b>I Licencuari/Të Licencuarit</b>	<b>Periudha e monitorimit</b>
1.	Monitorimi i zbatimit të planit të masave të Furnizuesit të shërbimit universal	FSHU sh.a.	1- Shtator -Tetor 2021/ 2- Maj -Qershor 2022
2.	Monitorim në FSHU mbi afatet dhe procedurat e trajtimit të ankesave të konsumatorit	FSHU sh.a.	1- Nëntor 2021 2- Maj 2022
3.	Analizimi i rezultateve tekniko ekonomike për periudhën Janar – Dhjetor 2021	OST sh.a.	Janar - Shkurt 2022
4.	Lidhur me disbalancat e energjisë elektrike, shërbimet ndihmëse dhe ankandet e kapaciteteve të energjisë elektrike, si dhe prokurimin e humbjeve në sistemin e transmetimit për periudhën Janar – Gusht 2021.	OST sh.a.	Shtator - Tetor 2021
5.	Mbi ecurinë e zbatimit të planit të investimeve për periudhën Janar – Nëntor 2021	OST sh.a.	Dhjetor 2021
6.	Niveli i transparencës në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi	OST sh.a.	Nëntor 2021
7.	Mbi ecurinë e zbatimit të planit të investimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2021	OSSH sh.a.	Prill - Maj 2022
8.	Lidhur me procedurat e shit/blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar për periudhën Janar – Djetor 2021	FTL sh.a.	Shkurt -Mars 2022
9.	Mbi procedurat e operimit të sistemit të faturimit të shoqërisë FSHU sh.a.	FSHU sh.a.	Maj - Qershor 2022
10.	Mbi sigurimin e aksesit të palëve të treta në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe akteve të miratuara nga ERE. Afatet brenda të cilave OSSH sh.a. realizon lidhjen e re	OSSH sh.a.	Dhjetor 2021/ Qershor 2022

11.	Mbi sigurimin e aksesit të palëve të treta në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe akteve të miratuara nga ERE. Afatet brenda të cilave OST sh.a. realizon lidhjen e re	OST sh.a.	Tetor 2021 - Maj 2022
12.	Zbatimi i detyrimeve të shërbimit publik dhe kontratave të rregulluara.	FSHU sh.a. ; KESH sh.a.	Prill – Maj 2022
	Lidhur me transaksionet e energjisë elektrike të kryera nga KESH sh.a. për periudhën Janar – Dhjetor 2021.	KESH sh.a.	Shkurt – Mars 2022
13.	Lidhur me zbatimin e Kodeve të Rrjetit.	OST sh.a. ; OSSH sh.a.	Maj - Qershor
14.	Monitorim i zbatimit të “Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike”.	OST sha ; OSSH sha , KESH dha	Mars - Prill 2022
15.	Ndjekja e procesit për ecurinë e operatorit të tregut të organizuar (Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike )	OST sh.a.	Tetor – Nëntor 2021
16.	Analizimi i rezultateve tekniko ekonomike për gjithë periudhën e operimit;  Monitorimi i prodhuesve, tregtarëve dhe furnizuesve në lidhje me mbajtjen e llogarive të ndara;  Monitorimi i prodhuesve, tregtarëve në lidhje me stafin teknik sipas strukturës organizative të paraqitur në ERE gjatë procesit të licencimit.	Përzgjedhja e shoqërive të licencuara do të bëhet nëpërmjet shortit të të licensuarve do të bëhet në rend kronologjik, sipas viteve të licencimit, (nga vitet më të hershme e në vijim).	Shtator 2021 -Shtator 2022
17.	Mbikëqyrja e ecurisë së investimeve të të licencuarit	Albgaz sh.a.	Dhjetor 2021